



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE**  
**-Këshilli Drejtues-**

---

**V E N D I M**

**Nr.1021, datë 06.11.2009**

**Për**

**çaktim numeracioni sipërmarrësit “Shkodra Intel.TV” sh.p.k**

Këshilli Drejtues i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare në mbledhjen e datës 06.11.2009, sipas rendit të ditës dhe procedurës së përcaktuar në nenin 7 e në vijim të Rregullores së Brendshme në fuqi, miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues nr. 170, datë 24.04.2004, e ndryshuar me Vendim të Këshillit Drejtues Nr. 452, datë 02.05.2008, e ndryshuar me Vendimin nr. 746, datë 17.07.2009, bazuar në ligjin Nr. 9918, datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, nëni 115 “Marrja e Vendimeve dhe Struktura e Këshillit Drejtues”, mori në shqyrtim:

- Propozimin e Drejtorisë së Liçensimit për miratimin e kërkesës së sipërmarrësit “Shkodra Intel.TV” shpk për çaktimin e 1000 numrave për përdorim në bashkinë Shkodër.

**BAZA LIGJORE :**

- Ligji Nr. 9918, datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, nëni 8 – pika j) dhe nenet 80 deri 90;
- “Rregullorja për çaktimin dhe përdorimin e numrave dhe serive numerike dhe Planit kombëtar të numeracionit” miratuar me VKD Nr. 932, datë 11.08.2009.
- Rregullorja e brendshme e AKEP miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues Nr. 170 datë 24.04.2004, e ndryshuar - nëni 21, pika 17.

Ne përfundim të interpretimit të bazës ligjore dhe kërkesës së sipërmarrësit të sipërcituar, Këshilli Drejtues

**V E N D O S I :**

1. Të miratojë kërkesën e sipërmarrësi “Shkodra Intel.TV” shpk për çaktimin e numeracionit, si më poshtë:

Nr	Bashkia	ND C	Diapazoni i SN		Kapaciteti i alokuar i SN	Konfigurimi i NSN (NDC+SN)
			Fillim	Mbarim		
1.	Shkodër	22	400.000	400.999	1.000	XX YYYYYY

- a) Formati i Numrit Sinjifikativ Kombëtar (NSN) është me 8-shifra, dhe ka konfigurimin e treguar në kolonë, ku shenjat X tregojnë sasinë e shifrave që formojnë NDC (Kodin e Destinimit

Kombëtar - *National Destination Code*) dhe shenjat **Y** tregojnë sasinë e shifrave që formojnë SN (Numrin e Pajtimtarit - *Subscriber Number*).

b) Formati i numrit për të realizuar thirrje :

- Kombëtare brenda Zonës së Numeracionit - vetëm SN
- Kombëtare jashtë Zonës së Numeracionit - **0 + NDC + SN [0 + NSN]**
- Ndërkombëtare: - **00 + CC + NSN**  
[ku : CC-Kodi (Prefiksi) i Vëndit]

### c) NUMERACIONI I SHKURTUAR

<b>0</b>	-	Prefiksi për thirrjet kombetare (brenda vëndit por jashtë zones perkatëse të numeracionit)
<b>00</b>	-	Prefiksi për thirrjet nderkombetare.
<b>112</b>	-	Numri i urgjencës <sup>1</sup> .
<b>118</b>	-	Rubrika e shërbimeve të Informacionit <sup>2</sup> .
<b>120</b>	-	Prenotim i komunikimeve kombetare
<b>1211</b>	-	Sinjalizim vështiresish në komunikimet kombetare.
<b>1212</b>	-	Sinjalizim vështiresish në komunikimet nderkombetare
<b>122</b>	-	Prenotim i komunikimeve nderkombetare.
<b>123</b>	-	Njoftim për prishje linje, telefoni.
<b>124</b>	-	Informacion për numërorin.
<b>126</b>	-	Policia Rrugore ( <i>Sherbim Urgjence</i> ) <sup>3</sup>
<b>127</b>	-	Urgjenca mjekësore ( <i>Sherbim urgjence</i> ) <sup>4</sup> .
<b>128</b>	-	Zjarrefiksati ( <i>Sherbim urgjence</i> ) <sup>5</sup> .
<b>129</b>	-	Policia e rendit ( <i>Sherbim urgjence</i> ) <sup>6</sup> .
<b>1891</b>	-	Hapja e kodit kombëtar / nderkombëtar nga terminale jo-multifrekuence.
<b>1892</b>	-	Mbyllja e kodit kombëtar / nderkombëtar nga terminale jo-multifrekuence.

2. Ngarkohen Drejtoria e Liçensimit për njoftimin e sipërmarrësit dhe Drejtoritë e tjera të AKEP për ndjekjen e efekteve që rrjedhin nga ky vendim.

## KRYETAR I KËSHILLIT DREJTUES

**Ilir SHEHU**

Anëtarë të Këshillit Drejtues:

<sup>1</sup> . Thirrjet në këte numer duhet të rrëzohen (direkt ose nepermjet bashkepunimet me sipërmarres të tjere të komunikimeve elektronike) në poste shërbimi që caktohen në marreveshje me autoritetet shtetërore kompetente të rrethit perkatës.

<sup>2</sup> . Në vartësi të sasisë së shërbimeve të veçanta që sipërmarresi kërkon të identifikojë brenda kësaj rubrike, kodi i shkurtër "118" mund të konfigurohet edhe në formën "118 X..". Në këte rast nuk merret miratim në AKEP, por vetëm njoftohet.

<sup>3</sup> . Thirrjet në këte numer duhet të rrëzohen (direkt ose nepermjet bashkepunimet me sipërmarres të tjere të komunikimeve elektronike) në poste shërbimi që caktohen në marreveshje me autoritetet shtetërore kompetente të rrethit perkatës.

<sup>4</sup> . I njejtë me shënimin nr.3.

<sup>5</sup> . I njejtë me shënimin nr.3.

<sup>6</sup> . I njejtë me shënimin nr.3.

1. Afrim TONUZI
2. Edlira KASAJ
3. Ilir ZELA
4. Jetmir KARINI